FLETORJA ZYRTARE
E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

www.qbz.gov.al

Botim i Qendrës së Botimeve Zyrtare

Viti: 2022 – Numri: 79

Tiranë – E enjte, 26 maj 2022

PËRMBAJTJA

		Faqe
Ligj nr. 49/2022, datën 12.5.2022	Për ratifikimin e protokollit ndryshues të Konventës "Për mbrojtjen e individëve, në lidhje me përpunimin automatik të të dhënave personale".....	10115
Dekret i Presidentit nr. 13622, datë 20.5.2022	Për shpallje ligji.....	10127
Udhëzim i ministrit të Infrastrukturës dhe Energjisë nr. 10, datë 20.4.2022	Për përcaktimin e procedurës, llojit dhe mënyrës për dhënien e shërbimeve *online* të Shërbimit Gjeologjik Shqiptar.....	10127
Udhëzim i ministrit të Brendshëm nr. 60, datë 9.5.2022	Për përbërjen dhe funksionimin e komisioneve të vlerësimit të gradave.....	10128
Udhëzim i ministrit të Brendshëm nr. 64, datë 12.5.2022	Për përcaktimin e kritereve të veçanta të dhënies së certifikatës, për ushtrimin e aktivitetit të ekspertit privat në fushën e mbrojtjes nga zjarri dhe shpëtimin.....	10130
	Bibliografia e informacionit të deklasifikuar "Sekret shtetëror" në Drejtorinë e Përgjithshme të Arkivave.....	10133
Njoftim i Ministrisë për Evropën dhe Punët e Jashtme nr. 6870, datë 20.5.2022	Mbi hyrjen në fuqi të një marrëveshjeje ndërkombëtare.....	10133
Vendim i Gjykatës së Apelit Shkodër nr. 53, datë 6.4.2022	Për njohjen dhe dhënien fuqi në Republikën e Shqipërisë, vendimit të huaj për çështjen civile me nr. 3744/18, datë 21.2.2019, të Gjykatës së *Lecce*-s, Republika e Italisë.....	10134
	Kërkesë për shpalljen të vdekur të shtetasit Xhavit Salia.....	10134

LIGJ
Nr. 49/2022

PËR RATIFIKIMIN E PROTOKOLLIT NDRYSHUES TË KONVENTËS "PËR MBROJTJEN E INDIVIDËVE, NË LIDHJE ME PËRPUNIMIN AUTOMATIK TË TË DHËNAVE PERSONALE"

Në mbështetje të neneve 78, 83 dhe 121, pika 1, të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

Neni 1

Ratifikohet protokolli ndryshues i Konventës "Për mbrojtjen e individëve, në lidhje me përpunimin automatik të të dhënave personale", sipas tekstit që i bashkëlidhet këtij ligji dhe është pjesë përbërëse e tij.

Neni 2

Në përputhje me nenin 21, pika 3, të protokollit ndryshues të Konventës "Për mbrojtjen e individëve, në lidhje me përpunimin automatik të të dhënave personale", Republika e Shqipërisë cakton si autoritet mbikëqyrës Komisionerin për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale me adresë: Rruga "Abdi Toptani", Tiranë, Shqipëri.

Neni 3
Shfuqizime

Në datën e hyrjes në fuqi të protokollit ndryshues të Konventës për Mbrojtjen e Individëve në lidhje me Përpunimin Automatik të të Dhënave Personale hyjnë në fuqi shfuqizimet e mëposhtme:

a) në ligjin nr. 9288, datë 7.10.2004, "Për ratifikimin e Konventës 'Për mbrojtjen e individëve, në lidhje me përpunimin automatik të të dhënave personale', të ndryshuar", nenet 2, 3 dhe 4 shfuqizohen;

b) ligji nr. 9287, datë 7.10.2004, "Për ratifikimin e protokollit shtesë të Konventës, 'Për mbrojtjen e individëve, në lidhje me përpunimin automatik të të dhënave personale nga organet mbikëqyrëse dhe fluksi ndërkufitar i të dhënave"' shfuqizohet.

Neni 4
Hyrja në fuqi

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Miratuar në datën 12.5.2022.

Shpallur me dekretin nr. 13622, datë 20.5.2022, të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Ilir Meta.

KËSHILLI I EVROPËS
Seria e Traktateve të Këshillit të Evropës – nr. 223

PROTOKOLL
QË NDRYSHON KONVENTËN PËR MBROJTJEN E INDIVIDËVE, NË LIDHJE ME PËRPUNIMIN AUTOMATIK TË TË DHËNAVE PERSONALE
STRASBURG, 10.X.2018

Hyrje

Shtetet anëtare të Këshillit të Evropës dhe Palët e tjera të Konventës për Mbrojtjen e Individëve, në lidhje me Përpunimin Automatik të të Dhënave Personale (ETS nr. 108) hapën për nënshkrim në Strasburg në datën 28 janar 1981 (në vijim e referuar si "Konventa"),

duke pasur parasysh rezolutën nr. 3 mbi mbrojtjen e të dhënave dhe privatësinë në mijëvjeçarin e tretë, të miratuar në Konferencën e 30-të të Këshillit të Evropës të Ministrave të Drejtësisë (Stamboll, Turqi, 24–26 nëntor 2010);

duke pasur parasysh rezolutën 1843 (2011) të Asamblesë Parlamentare të Këshillit të Evropës për mbrojtjen e privatësisë dhe të dhënave personale në internet dhe mediave *online* dhe Rezolutën 1986 (2014), për përmirësimin e mbrojtjes dhe sigurisë së përdoruesve në hapësirën kibernetike;

duke pasur parasysh opinionin 296 (2017) mbi draftprotokollin që ndryshon Konventën për Mbrojtjen e Individëve, në lidhje me Përpunimin

Automatik të të Dhënave Personale (ETS nr. 108) dhe memorandumin e tij shpjegues, të miratuara nga Komiteti i Përhershëm në emër të Asamblesë Parlamentare të Këshillit të Evropës, më 24 nëntor 2017;

duke marrë parasysh se u shfaqën sfida të reja që prej miratimit të Konventës për mbrojtjen e individëve, në lidhje me përpunimin e të dhënave personale;

duke marrë parasysh nevojën për të garantuar që Konventa të vazhdojë të luajë rolin e saj më të rëndësishëm në mbrojtjen e individëve, në lidhje me përpunimin e të dhënave personale dhe më përgjithësisht, në mbrojtjen e të drejtave të njeriut dhe lirive themelore,

kanë rënë dakord, si vijon:

Neni 1

1. Paragrafi i parë i hyrjes së Konventës do të zëvendësohet, si vijon:

"Shtetet Anëtare të Këshillit të Evropës dhe nënshkruesit e tjerë të saj,".

2. Paragrafi i tretë i hyrjes së Konventës do të zëvendësohet, si vijon:

"Duke marrë parasysh që është e nevojshme të sigurohet dinjiteti i individëve dhe mbrojtja e të drejtave të njeriut dhe liritë themelore të çdo personi dhe duke pasur parasysh diversifikimin, intensifikimin dhe globalizimin e përpunimit të të dhënave dhe qarkullimet e të dhënave personale, autonominë personale bazuar në të drejtën e një personi për të kontrolluar të dhënat e tij ose të saj personale dhe përpunimin e këtyre të dhënave;".

3. Paragrafi i katërt i hyrjes së Konventës do të zëvendësohet, si më poshtë:

"Duke kujtuar se e drejta për mbrojtjen e të dhënave personale duhet të konsiderohet në lidhje me rolin e saj në shoqëri dhe se duhet të lidhet me të drejtat e tjera të njeriut dhe liritë themelore, duke përfshirë lirinë e shprehjes;".

4. Paragrafi i mëposhtëm do të shtohet pas paragrafit të katërt të hyrjes së Konventës:

"Duke marrë parasysh që kjo Konventë lejon që në zbatimin e rregullave të përcaktuara në të, të merret parasysh edhe parimi i së drejtës për akses në dokumente zyrtare;".

5. Paragrafi i pestë i hyrjes së Konventës do të fshihet. Do të shtohen paragrafët e reja pesë dhe gjashtë, të cilat lexojnë si më poshtë:

"Duke pranuar se është e nevojshme të promovohen në nivel global vlerat themelore të respektimit të privatësisë dhe mbrojtjes së të dhënave personale, duke kontribuar në qarkullimin e lirë të informacionit midis njerëzve;".

"Duke pranuar interesin e një përforcimi të bashkëpunimit ndërkombëtar midis Palëve të Konventës,".

Neni 2

Teksti i nenit 1 të Konventës do të zëvendësohet, si vijon:

"Qëllimi i kësaj Konvente është mbrojtja e çdo individi, çfarëdo qoftë shtetësia apo rezidenca e tij ose saj, në lidhje me përpunimin e të dhënave të tyre personale, duke kontribuar në respektimin e të drejtave të njeriut të tij apo të saj dhe lirive themelore dhe në veçanti, të drejtën e privatësisë.".

Neni 3

1. Shkronja "b" e nenit 2 të Konventës do të zëvendësohet, si vijon:

"b) "përpunim i të dhënave" do të thotë çdo veprim apo grup veprimesh që kryhet mbi të dhënat personale, si: mbledhja, arkivimi, ruajtja, ndryshimi, korrigjimi, përhapja, vënia në dispozicion, fshirja ose shkatërrimi apo kryerja e veprimeve aritmetike dhe/ose logjike mbi këto të dhëna;".

2. Shkronja "c" e nenit 2 të Konventës do të zëvendësohet, si vijon:

"c) kur përpunimi automatik nuk përdoret, "përpunimi i të dhënave" nënkupton një veprim ose grup veprimesh të kryera mbi të dhënat personale brenda një grupi të strukturuar të të dhënave, të cilat janë të aksesueshme ose të rikuperueshme sipas kritereve specifike;".

3. Shkronja "d" e nenit 2 të Konventës do të zëvendësohet, si vijon:

"d. "kontrollues" do të thotë personi fizik ose juridik, autoriteti publik, shërbimi, agjencia ose ndonjë organ tjetër i cili, vetëm ose bashkërisht me të tjerët, ka fuqi vendimmarrëse, në lidhje me përpunimin e të dhënave;".

4. Pas shkronjës d të nenit 2 të Konventës do të shtohen shkronjat e reja të mëposhtme:

"e) "marrës" nënkupton një person fizik ose juridik, autoritet publik, shërbim, agjenci ose

ndonjë organ tjetër, të cilit i janë përhapur ose vënë në dispozicion të dhënat;

f) "përpunues" nënkupton një person fizik ose juridik, autoritet publik, shërbim, agjenci ose ndonjë organ tjetër, i cili përpunon të dhënat personale në emër të kontrolluesit.".

Neni 4

1. Paragrafi 1 i nenit 3 të Konventës do të zëvendësohet, si vijon:

"1. Secila Palë merr përsipër të zbatojë këtë Konventë për përpunimin e të dhënave që i nënshtrohet juridiksionit të saj në sektorët publikë dhe privatë, duke siguruar kështu të drejtën e çdo individi për mbrojtjen e të dhënave personale të tij ose të saj.".

2. Paragrafi 2 i nenit 3 të Konventës do të zëvendësohet, si vijon:

"2. Kjo Konventë nuk do të zbatohet për përpunimin e të dhënave, të kryer nga një individ gjatë aktiviteteve personale apo familjare.".

3. Paragrafët 3 deri në 6 të nenit 3 të Konventës do të fshihen.

Neni 5

Titulli i kapitullit II të Konventës do të zëvendësohet, si vijon:

"Kapitulli II – Parimet bazë për mbrojtjen e të dhënave personale".

Neni 6

1. Paragrafi 1 i nenit 4 të Konventës do të zëvendësohet, si vijon:

"1. Secila Palë do të marrë masat e nevojshme në ligjin e saj për të zbatuar dispozitat e kësaj Konvente dhe për të siguruar zbatimin efektiv të tyre.".

2. Paragrafi 2 i nenit 4 të Konventës do të zëvendësohet, si vijon:

"2. Këto masa do të ndërmerren nga secila Palë dhe do të hyjnë në fuqi në kohën e ratifikimit ose të aderimit në këtë Konventë.".

3. Pas paragrafit 2 të nenit 4 të Konventës do të shtohet një paragraf i ri:

"3. Secila Palë zotohet:

a) të lejojë Komitetin e Konventës të parashikuar në kapitullin VI për të vlerësuar efektivitetin e masave që ka marrë në ligjin e saj për të zbatuar dispozitat e kësaj Konvente; dhe

b) të kontribuojë në mënyrë aktive në këtë proces vlerësimi.".

Neni 7

1. Titulli i nenit 5 do të zëvendësohet, si vijon:

"Neni 5 – Legjitimiteti i përpunimit të të dhënave dhe cilësisë së të dhënave".

2. Teksti i nenit 5 të Konventës do të zëvendësohet, si vijon:

1. Përpunimi i të dhënave duhet të jetë proporcional, në raport me qëllimin legjitim të ndjekur dhe të reflektojë në të gjitha fazat e përpunimit një balancë të drejtë midis të gjitha interesave përkatës, qoftë publikë apo privatë, dhe të drejtat dhe liritë në fjalë.

2. Çdo Palë do të garantojë që përpunimi i të dhënave mund të kryhet bazuar në pëlqimin e lirë, specifik, të informuar dhe të qartë të subjektit të të dhënave ose të ndonjë baze tjetër legjitime të përcaktuar me ligj.

3. Të dhënat personale, që i nënshtrohen përpunimit, do të përpunohen në mënyrë të ligjshme.

4. Të dhënat personale, që i nënshtrohen përpunimit, do të:

a) përpunohen në mënyrë të drejtë dhe transparente;

b) të mblidhen për qëllime të qarta, të specifikuara dhe të ligjshme dhe të mos përpunohen në një mënyrë të papajtueshme me ato qëllime; përpunimi i mëtejshëm për qëllime arkivimi në interes të publikut, qëllimet kërkimore shkencore ose historike ose qëllime statistikore, u nënshtrohet masave të përshtatshme mbrojtëse, në përputhje me ato qëllime;

c) jenë të mjaftueshme, të rëndësishme dhe jo të tepërta, në lidhje me qëllimet për të cilat ato përpunohen;

d) jenë të sakta dhe kur është e nevojshme, të përditësohen;

e) të ruhen në një mënyrë që lejon identifikimin e subjekteve të të dhënave, jo më gjatë seç është e nevojshme për qëllimet që përpunohen ato të dhëna.".

Neni 8

Teksti i nenit 6 të Konventës do të zëvendësohet, si vijon:

"1. Përpunimi i:

- të dhënave gjenetike;

- të dhënat personale, në lidhje me veprat penale, procedimet penale dhe dënimet, si dhe masat përkatëse të sigurisë;

- të dhënave biometrike që identifikojnë një person në mënyrë unike;

- të dhënat personale për informacionin që zbulojnë, në lidhje me origjinën racore ose etnike, mendimet politike, anëtarësimin në sindikata, besimet fetare ose të tjera, shëndetin ose jetën seksuale,

do të lejohen vetëm kur të jenë përcaktuar masa të përshtatshme mbrojtëse në ligj, duke plotësuar ato të kësaj Konvente.

2. Këto masa mbrojtëse do të mbrojnë kundër rreziqeve që mund të paraqesë përpunimi i të dhënave sensitive për interesat, të drejtat dhe liritë themelore të subjektit të të dhënave, sidomos rreziku i diskriminimi.".

Neni 9

Teksti i nenit 7 të Konventës do të zëvendësohet, si vijon:

"1. Çdo palë duhet të parashikojë që kontrolluesi dhe në rastet e përpunuesit, të ndërmarrë masat e përshtatshme të sigurisë ndaj risqeve, si aksesi i paautorizuar ose aksidental për shkatërrimin, humbjen, përdorimin, modifikimin ose përhapjen e të dhënave personale.

2. Çdo palë duhet të parashikojë që kontrolluesi duhet të njoftojë pa vonesë, të paktën autoritetin kompetent mbikëqyrës, sipas kuptimit të nenit 15 të kësaj Konvente, për ato shkelje të të dhënave të cilat mund të ndërhyjnë seriozisht në të drejtat dhe liritë themelore të subjekteve të të dhënave.".

Neni 10

Një nen i ri 8 do të shtohet pas nenit 7 të Konventës, si vijon:

"Neni 8 – Transparenca e përpunimit

1. Çdo palë do të parashikojë në ligj se kontrolluesi duhet të informojë subjektet e të dhënave, për:

a) identitetin e saj ose të tij dhe vendbanimin ose rezidencën;

b) bazën ligjore dhe qëllimet e përpunimit të synuar;

c) kategoritë e të dhënave personale që përpunohen;

d) marrësit ose kategoritë e marrësve të të dhënave personale, nëse ka; dhe

e) mjetet për ushtrimin e të drejtave të përcaktuara në nenin 9,

si edhe çdo informacion shtesë të nevojshëm për të garantuar përpunim të drejtë dhe transparent të të dhënave personale.

2. Paragrafi 1 nuk do të zbatohet, kur subjekti i të dhënave e ka informacionin përkatës.

3. Kur të dhënat personale nuk janë mbledhur nga subjektet e të dhënave, kontrolluesit nuk do t'i kërkohet të japë atë informacion kur përpunimi përshkruhet shprehimisht me ligj ose kjo provon të jetë e pamundur apo përfshin përpjekje joproporcionale.".

Neni 11

1. Neni 8 i mëparshëm i Konventës do të renditet si neni 9 dhe titulli i tij do të zëvendësohet, si vijon:

"Neni 9 – Të drejtat e subjektit të të dhënave".

2. Teksti i nenit 8 të Konventës (neni 9 i ri) do të zëvendësohet, si vijon:

"1. Çdo individ do të ketë të drejtën, që:

a) të mos i nënshtrohet një vendimi që ka ndikim domethënës për të bazuar vetëm në një përpunim automatik të të dhënave pa marrë në konsideratë mendimin e tij ose të saj;

b) të marrë me kërkesë, në kohë të arsyeshme dhe pa vonesë ose shpenzime, konfirmimin e përpunimit të të dhënave personale që i përkasin atij ose asaj, komunikimin në formë të kuptueshme të të dhënave të përpunuara, të gjithë informacionin e disponueshëm për origjinën e tyre, periudhën e ruajtjes si edhe çdo informacion tjetër që kontrolluesi duhet të japë për të garantuar transparencën e përpunimit në përputhje me nenin 8, paragrafi 1;

c) për të marrë, sipas kërkesës, njohjen e arsyetimit që bazohet në përpunimin e të dhënave, kur rezultatet e një përpunimi të tillë zbatohen ndaj tij ose saj;

d) të kundërshtojë në çdo kohë, me baza lidhur me situatën e tij ose të saj, përpunimin e të dhënave personale, në lidhje me të, përveç nëse kontrolluesi demonstron baza legjitime për përpunimin e të cilave mbizotërojnë interesat e tij ose të drejtat dhe liritë themelore;

e) për të marrë, sipas kërkesës, pa pagesë dhe pa vonesë të tepërt, korrigjim ose fshirje, sipas rastit, të këtyre të dhënave nëse ato kanë qenë ose janë përpunuar në kundërshtim me dispozitat e kësaj Konvente;

f) të ketë një mjet juridik, sipas nenit 12 ku të drejtat e tij ose të saj, sipas kësaj Konvente janë shkelur;

g) për të përfituar, pavarësisht nga shtetësia ose vendbanimi i tij, nga ndihma e një autoriteti mbikëqyrës, në kuptim të nenit 15, në ushtrimin e të drejtave të tij ose të saj, sipas kësaj Konvente.

2. Paragrafi 1(a) nuk do të zbatohet nëse vendimi është i autorizuar nga një ligj nga ku kontrollori është subjekt dhe i cili, gjithashtu, përcakton masat e përshtatshme për të mbrojtur të drejtat, liritë dhe interesat legjitimë të subjektit të të dhënave.”.

Neni 12

Një nen i ri 10 do të shtohet pas nenit 9 të ri të Konventës, si vijon:

“Neni 10 – Detyrimet shtesë

1. Secila Palë do të sigurojë që kontrolluesit dhe, sipas rastit, përpunuesit të marrin të gjitha masat e përshtatshme për të përmbushur detyrimet e kësaj Konvente dhe të jenë në gjendje të demonstrojnë, duke iu nënshtruar legjislacionit të brendshëm të miratuar, në përputhje me nenin 11, paragrafi 3, në veçanti, për autoritetin mbikëqyrës kompetent të parashikuar në nenin 15, se përpunimi i të dhënave nën kontrollin e tyre, është në përputhje me dispozitat e kësaj Konvente.

2. Secila palë do të parashikojë që kontrolluesit dhe, sipas rastit, përpunuesit, të shqyrtojnë ndikimin e mundshëm të përpunimit të të dhënave, në lidhje me të drejtat dhe liritë themelore të subjekteve të të dhënave, para fillimit të këtij përpunimi dhe do të projektojë përpunimin e të dhënave, në mënyrë të tillë që të parandalojë ose të minimizojë rrezikun e ndërhyrjes në ato të drejta dhe liri themelore.

3. Secila Palë do të parashikojë që kontrolluesit dhe, sipas rastit, përpunuesit, të zbatojnë masa teknike dhe organizative, të cilat marrin parasysh ndërlikimet e së drejtës për mbrojtjen e të dhënave personale në të gjitha fazat e përpunimit të të dhënave.

4. Secila Palë, duke marrë parasysh rreziqet, që lindin për interesat, të drejtat dhe liritë themelore të subjekteve të të dhënave, mund të përshtatë zbatimin e dispozitave të paragrafëve 1, 2 dhe 3, në ligjin që i jep fuqi dispozitave të kësaj Konvente, sipas natyrës dhe volumit të të dhënave, natyra, fusha e zbatimit dhe qëllimi i përpunimit dhe, sipas rastit, madhësinë e kontrolluesit ose përpunuesit.”.

Neni 13

Ish-nenet 9 deri 12 të Konventës do të bëhen nenet 11 deri 14 të Konventës.

Neni 14

Teksti i nenit 9 të Konventës (neni i ri 11) do të zëvendësohet, si vijon:

“1. Asnjë përjashtim nga dispozitat e përcaktuara në këtë kapitull nuk do lejohet me përjashtim të dispozitave të nenit 5, paragrafi 4; nenit 7, paragrafi 2; neni 8, paragrafi 1, dhe neni 9, kur një përjashtim i tillë parashikohet me ligj, me respekt thelbin e të drejtave dhe lirive themelore dhe përbën një masë të nevojshme dhe proporcionale në një shoqëri demokratike, për:

a) mbrojtjen e sigurisë kombëtare, mbrojtjen, sigurinë publike, interesat e rëndësishëm ekonomikë dhe financiarë të shtetit, paanësinë dhe pavarësinë e gjyqësorit ose parandalimin, hetimin dhe ndjekjen penale të veprave penale dhe ekzekutimin e dënimeve penale dhe objektiva të tjerë esencialë të interesit të përgjithshëm publik;

b) mbrojtjen e subjektit të të dhënave ose të drejtat dhe liritë themelore të të tjerëve, veçanërisht, lirinë e shprehjes.

2. Kufizimet në ushtrimin e dispozitave të përcaktuara në nenet 8 dhe 9 mund të parashikohen me ligj, në lidhje me përpunimin e të dhënave për qëllime arkivimi, në interes të publikut, qëllime shkencore ose historike kërkimore ose qëllime statistikore, kur nuk ka rrezik të dallueshëm ose shkelje të të drejtave dhe të lirive themelore të subjekteve të të dhënave.

3. Përveç përjashtimeve të lejuara në paragrafin 1 të këtij neni, duke iu referuar aktiviteteve të përpunimit për qëllime të sigurisë kombëtare dhe të mbrojtjes, secila Palë mund të përcaktojë, me ligj dhe vetëm në masën që ajo përbën një masë të nevojshme dhe proporcionale në një shoqëri demokratike, për të përmbushur një qëllim të tillë, përjashtime për nenin 4, paragrafi 3; nenin 14, paragrafët 5 dhe 6 dhe nenin 15, paragrafi 2, shkronjat "a", "b", "c" dhe "d".

Kjo nuk cenon kërkesën që aktivitetet e përpunimit, për qëllime të sigurisë kombëtare dhe të mbrojtjes, t'i nënshtrohen rishikimit dhe mbikëqyrjes së pavarur dhe efektive, sipas legjislacionit të brendshëm të Palës përkatëse.".

Neni 15

Teksti i nenit 10 të Konventës (neni i ri 12) zëvendësohet, si vijon:

"Çdo Palë merr përsipër të vendosë sanksione dhe mjete të përshtatshme gjyqësore dhe jogjyqësore për shkeljet e dispozitave të kësaj Konvente.".

Neni 16

Titulli i kapitullit III zëvendësohet, si vijon:

"Kapitulli III – Qarkullimet ndërkufitare të të dhënave personale".

Neni 17

1. Titulli i nenit 12 të Konventës (neni i ri 14) zëvendësohet, si vijon:

"Neni 14 – Qarkullimet ndërkufitare të të dhënave personale".

2. Teksti i nenit 12 të Konventës (neni i ri 14) zëvendësohet, si vijon:

"1. Një Palë, me qëllim të vetëm të mbrojtjes së të dhënave personale, nuk ndalon ose i nënshtrohet autorizimit të veçantë për transferimin e këtyre të dhënave te një marrës që është nën juridiksionin e një Pale tjetër të Konventës. Megjithatë, një Palë e tillë mund ta bëjë këtë nëse ekziston një rrezik real dhe serioz që transferimi te një Palë tjetër ose nga ajo Palë tjetër në një jopalë, do të çonte në shmangien e dispozitave të Konventës. Një Palë mund ta bëjë këtë edhe nëse është e lidhur me rregulla të harmonizuara të mbrojtjes të përbashkëta nga shtetet që i përkasin një organizate ndërkombëtare rajonale.

2. Kur marrësi i nënshtrohet juridiksionit të një shteti ose organizate ndërkombëtare që nuk është palë në këtë Konventë, transferimi i të dhënave personale mund të bëhet vetëm, kur garantohet një nivel i përshtatshëm mbrojtjeje bazuar në dispozitat e kësaj Konvente.

3. Niveli i përshtatshëm i mbrojtjes mund të sigurohet nga:

a) ligji i atij shteti ose organizate ndërkombëtare, përfshirë traktatet ose marrëveshjet ndërkombëtare të zbatueshme; ose

b) masa të standardizuara *ad hoc* ose të miratuara të parashikuara nga instrumente të zbatueshme dhe të detyrueshëm ligjërisht të miratuar dhe zbatuar nga personat e përfshirë në transferim dhe përpunim të mëtejshëm.

4. Pavarësisht nga dispozitat e paragrafëve të mëparshëm, secila Palë mund të parashikojë se transferimi i të dhënave personale mund të kryhet, nëse:

a) subjekti i të dhënave ka dhënë pëlqimin e qartë, specifik dhe të lirë, pasi është informuar për rreziqet që lindin në mungesë të masave të duhura mbrojtëse; ose

b) interesat specifikë të subjektit të të dhënave e kërkojnë atë në rastin e veçantë; ose

c) interesat e ligjshëm mbizotërues, në veçanti interesa të rëndësishëm publikë, parashikohen me ligj dhe ky transferim përbën një masë të nevojshme dhe proporcionale në një shoqëri demokratike; ose

d) ai përbën një masë të nevojshme dhe proporcionale në një shoqëri demokratike për lirinë e shprehjes.

5. Secila palë do të sigurojë që autoriteti mbikëqyrës kompetent, në kuptim të nenit 15 të kësaj Konvente, të ketë të gjitha informacionet përkatëse, në lidhje me transferimin e të dhënave të përmendura në paragrafin 3, shkronja "b" dhe, me kërkesë, paragrafi 4, shkronjat "b" dhe "c".

6. Secila palë, gjithashtu, do të sigurojë që autoriteti mbikëqyrës ka të drejtë të kërkojë që personi që transferon të dhëna, të demonstrojë efektivitetin e masave mbrojtëse ose ekzistencën e interesave legjitimë mbizotërues dhe se autoriteti mbikëqyrës, në mënyrë që të mbrojë të drejtat dhe liritë themelore të subjekteve të të dhënave, të

ndalojnë transferime të tilla, pezullojnë ose t'i nënshtrojnë ato sipas kushteve.".

3. Teksti i nenit 12 të Konventës (neni i ri 14) përfshin dispozitat e nenit 2 të Protokollit Shtesë të vitit 2001, në lidhje me autoritetet mbikëqyrëse dhe qarkullimet ndërkufitare të të dhënave (ETS nr. 181) për qarkullimet ndërkufitare të të dhënave personale te një marrës, i cili nuk i nënshtrohet juridiksionit të një Pale të Konventës.

Neni 18

Pas Kapitullit III të Konventës do të shtohet kapitulli i ri IV si më poshtë:

"Kapitulli IV – Autoritetet mbikëqyrëse".

Neni 19

Një nen i ri 15 përfshin dispozitat e nenit 1 të Protokollit Shtesë të vitit 2001 (ETS nr. 181) dhe parashikon, si vijon:

"Neni 15 – Autoritetet mbikëqyrëse

1. Secila palë do të parashikojë që një ose më shumë autoritete të jenë përgjegjëse për garantimin e përputhshmërisë me dispozitat e kësaj Konvente.

2. Për këtë qëllim, këto autoritete:

a) do të kenë fuqi hetuese dhe ndërhyrëse;

b) do të kryejnë funksionet që lidhen me transferimin e të dhënave të parashikuara në nenin 14, veçanërisht miratimin e masave mbrojtëse të standardizuara;

c) do të kenë kompetenca për të nxjerrë vendime në lidhje me shkeljet e dispozitave të kësaj Konvente dhe mund të vendosin, në veçanti, sanksione administrative;

d) do të ketë kompetencën për t'u angazhuar në procedura ligjore ose për të vënë në vëmendjen e autoriteteve kompetente gjyqësore shkelje të dispozitave të kësaj Konvente;

e) do të promovojnë:

i. ndërgjegjësimin e publikut për funksionet dhe kompetencat e tyre, si dhe për aktivitetet e tyre;

ii. ndërgjegjësimin e publikut për të drejtat e subjekteve të të dhënave dhe ushtrimin e këtyre të drejtave;

iii. ndërgjegjësimin e kontrolluesve dhe të përpunuesve për përgjegjësitë e tyre, sipas kësaj Konvente,

vëmendje e veçantë do t'u jepet të drejtave të mbrojtjes së të dhënave të fëmijëve dhe individëve të tjerë të cenueshëm.

3. Autoritetet kompetente mbikëqyrëse duhet të konsultohen në propozime për çdo masë legjislative ose administrative që parashikon përpunimin e të dhënave personale.

4. Çdo autoritet kompetent mbikëqyrës do të merret me kërkesat dhe ankesat e paraqitura nga subjektet e të dhënave, në lidhje me të drejtat e tyre të mbrojtjes së të dhënave, dhe do t'i mbajë subjektet e të dhënave të informuar për ecurinë.

5. Autoritetet mbikëqyrëse do të veprojnë me pavarësi dhe paanësi të plotë në kryerjen e detyrave të tyre dhe ushtrimin e kompetencave të tyre dhe, në këtë mënyrë, nuk do të kërkojnë dhe pranojnë udhëzime.

6. Çdo Palë do të garantojë që autoriteteve mbikëqyrëse t'u sigurohen burimet e nevojshme për kryerjen efektive të funksioneve dhe ushtrimin e kompetencave të tyre.

7. Çdo autoritet mbikëqyrës do të përgatitë dhe do të publikojë një raport periodik, që përshkruan aktivitetet e tij.

8. Anëtarët dhe stafi i autoriteteve mbikëqyrëse i nënshtrohen detyrimit të konfidencialitetit, në lidhje me informacionin konfidencial në të cilin ata kanë ose kanë pasur akses gjatë kryerjes së detyrave dhe ushtrimin e kompetencave të tyre.

9. Vendimet e autoriteteve mbikëqyrëse mund të apelohen në gjykatë.

10. Autoritetet mbikëqyrëse nuk do të jenë kompetente, në lidhje me përpunimin e kryer nga organet kur veprojnë në cilësinë e tyre gjyqësore.".

Neni 20

1. Kapitujt IV deri VII të Konventës rinumërohen në kapitujt V deri VIII të Konventës.

2. Titulli i kapitullit V zëvendësohet me "Kapitullin V – Bashkëpunimi dhe asistenca e ndërsjellë".

3. Shtohet një nen i ri 17 dhe nenet e mëparshme 13 deri 27 të Konventës do të bëhen nenet 16 deri 31 të Konventës.

Neni 21

1. Titulli i nenit 13 të Konventës (neni i ri 16) zëvendësohet, si vijon:

"Neni 16 – Përcaktimi i autoriteteve mbikëqyrëse".

2. Paragrafi 1 i nenit 13 të Konventës (neni i ri 16) zëvendësohet me sa vijon:

"1. Palët bien dakord të bashkëpunojnë dhe të vendosin asistencën e ndërsjellë për zbatimin e kësaj Konvente.".

3. Paragrafi 2 i nenit 13 të Konventës (neni i ri 16) zëvendësohet, si vijon:

"2. Për atë qëllim:

a) çdo Palë do të caktojë një ose më shumë autoritete mbikëqyrëse, brenda kuptimit të nenit 15 të kësaj Konvente, emrin dhe adresën e secilës prej të cilave që do t'i komunikojë Sekretarit të Përgjithshëm të Këshillit të Evropës;

b) çdo palë që ka caktuar më shumë se një autoritet mbikëqyrës duhet të specifikojë kompetencën e secilit autoritet në komunikimin e përmendur në përshkrimin e mëparshëm.".

4. Paragrafi 3 i nenit 13 të Konventës (neni i ri 16) do të fshihet.

Neni 22

Një nen i ri 17 shtohet pas nenit të ri 16 të Konventës, si më poshtë:

"Neni 17 – Mënyrat e bashkëpunimit

1. Autoritetet mbikëqyrëse bashkëpunojnë me njëri-tjetrin në masën e nevojshme për kryerjen e detyrave të tyre dhe ushtrimin e kompetencave të tyre, në veçanti duke:

a) ofrimin e asistencës së ndërsjellë, duke shkëmbyer informacione përkatëse dhe të dobishme dhe duke bashkëpunuar me njëri-tjetrin, me kusht që, sa i përket mbrojtjes së të dhënave personale, të respektohen të gjitha rregullat dhe masat mbrojtëse të kësaj Konvente;

b) koordinimin e hetimeve apo i ndërhyrjeve të tyre, për kryerjen e veprimeve të përbashkëta;

c) duke dhënë informacion dhe dokumentacion mbi ligjin dhe praktikën e tyre administrative, në lidhje me mbrojtjen e të dhënave.

2. Informacioni i referuar në paragrafin 1 nuk përfshin të dhënat personale që i nënshtrohen përpunimit, përveç nëse të dhënat e tilla janë thelbësore për bashkëpunimin ose kur subjekti i të dhënave në fjalë ka dhënë pëlqim të qartë, specifik, të lirë dhe të informuar për dhënien e tij.

3. Për të organizuar bashkëpunimin e tyre dhe për të kryer detyrat e përcaktuara në paragrafët e mësipërm, autoritetet mbikëqyrëse të Palëve do të formojnë një rrjet.".

Neni 23

1. Titulli i nenit 14 të Konventës (neni i ri 18) zëvendësohet, si vijon:

"Neni 18 – Asistencë për subjektet e të dhënave".

2. Teksti i nenit 14 të Konventës (neni i ri 18) zëvendësohet, si vijon:

"1. Çdo Palë do të asistojë çdo subjekt të të dhënave, pavarësisht nga shtetësia ose rezidenca e tij, për të ushtruar të drejtat e tij ose të saj, sipas nenit 9 të kësaj Konvente.

2. Kur një subjekt i të dhënave banon në territorin e një Pale tjetër, atij ose asaj do t'i jepet mundësia e paraqitjes së kërkesës përmes ndërmjetësimit të autoritetit mbikëqyrës të caktuar nga ajo Palë.

3. Kërkesa për asistencë përmban të gjitha detajet e nevojshme, që ndërlidhen, ndër të tjera, me:

a) emrin, adresën dhe çdo detaj tjetër përkatës, që identifikon subjektin e të dhënave që bën kërkesën;

b) përpunimin ndaj së cilit shoqërohet kërkesa ose kontrolluesin e tij;

c) qëllimi i kërkesës.".

Neni 24

1. Titulli i nenit 15 të Konventës (neni i ri 19) zëvendësohet, si vijon:

"Neni 19 – Masat mbrojtëse".

2. Teksti i nenit 15 të Konventës (neni i ri 19) zëvendësohet, si vijon:

"1. Autoriteti mbikëqyrës, i cili ka marrë informacione nga një autoritet tjetër mbikëqyrës, ose duke e shoqëruar me një kërkesë apo duke iu përgjigjur kërkesës së vet, nuk do ta përdorë atë informacion për qëllime të ndryshme nga ato të specifikuara në kërkesë.

2. Në asnjë rast nuk mund të lejohet një autoritet mbikëqyrës që të bëjë një kërkesë në emër të një subjekti të të dhënave në vetvete dhe pa miratimin e saktë të subjektit të të dhënave përkatës.".

Neni 25

1. Titulli i nenit 16 të Konventës (neni i ri 20) zëvendësohet, si vijon:

"Neni 20 – Refuzimi i kërkesave".

2. Paragrafi i nenit 16 të Konventës (neni i ri 20) zëvendësohet, si vijon:

"Autoriteti mbikëqyrës, të cilit i drejtohet një kërkesë, sipas nenit 17 të kësaj Konvente, nuk mund të refuzojë përmbushjen e saj, përveç nëse:".

3. Shkronja "a" e nenit 16 të Konventës (neni i ri 20) zëvendësohet, si vijon:

"a) Kërkesa nuk është në pajtueshmëri me kompetencat e saj.".

4. Shkronja "c" e nenit 16 të Konventës (neni i ri 20) do të zëvendësohet, si vijon:

"c) përputhshmëria me kërkesën do të ishte e papajtueshme me sovranitetin, sigurinë kombëtare ose rendin publik të Palës nga e cila ishte përcaktuar ose me të drejtat dhe liritë themelore të individëve nën juridiksionin e asaj Pale.".

Neni 26

1. Titulli i nenit 17 të Konventës (neni i ri 21) zëvendësohet me sa vijon:

"Neni 21 – Kostot dhe procedurat".

2. Paragrafi 1 i nenit 17 të Konventës (neni i ri 21) zëvendësohet, si vijon:

"1. Bashkëpunimi dhe asistenca e ndërsjellë që Palët i japin njëra-tjetrës, sipas nenit 17 dhe ndihma që ata u japin subjekteve të të dhënave, bazuar në nenet 9 dhe 18, nuk do të shkaktojnë pagesën e ndonjë kostoje ose tarifë, përveç atyre të bëra për ekspertët dhe interpretët. Kostot ose tarifat e fundit do të përballohen nga Pala që bën kërkesën.".

3. Shprehjet "e tij/saj" do të zëvendësojnë "të tij" në paragrafin 2 të nenit 17 të Konventës (neni i ri 21).

Neni 27

Titulli i kapitullit V të Konventës (kapitulli i ri VI) zëvendësohet me sa vijon:

"Kapitulli VI – Komiteti i Konventës".

Neni 28

1. Termi "Komiteti Konsultativ" në paragrafin 1 të nenit 18 të Konventës (neni i ri 22) zëvendësohet nga "Komiteti i Konventës".

2. Paragrafi 3 i nenit 18 të Konventës (neni i ri 22) zëvendësohet me sa vijon:

"3. Komiteti i Konventës mund të ftojë një vëzhgues të përfaqësohet në mbledhjet e tij, me një vendim të marrë nga shumica e dy të tretave të përfaqësuesve të Palëve.".

3. Një paragraf i ri 4 do të shtohet pas paragrafit 3 të nenit 18 të Konventës (neni i ri 22):

"4. Çdo Palë e cila nuk është anëtare e Këshillit të Evropës do të kontribuojë në financimin e veprimtarive të Komitetit të Konventës, sipas modaliteteve të përcaktuara nga Komiteti i Ministrave në marrëveshje me atë Palë.".

Neni 29

1. Termi "Komitet Konsultativ" në përshkrimin e nenit 19 të Konventës (neni i ri 23) zëvendësohet nga "Komiteti i Konventës".

2. Shprehja "propozime" në shkronjën "a" të nenit 19 të Konventës (neni i ri 23) zëvendësohet me termin "rekomandime".

3. Referencat për "nenin 21" në shkronjën "b" dhe "neni 21, paragrafi 3" në shkronjën "c" të nenit 19 të Konventës (neni i ri 23) zëvendësohet respektivisht nga referencat për "nenin 25" dhe "neni 25, paragrafi 3".

4. Shkronja "d" e nenit 19 të Konventës (neni i ri 23) zëvendësohet me sa vijon:

"d) mund të shprehë opinion mbi çdo çështje lidhur me interpretimin ose zbatimin e kësaj Konvente;".

5. Shkronja vijuese e shtesë do të shtohet pas shkronjës "d" të nenit 19 të Konventës (neni i ri 23):

"e) do të përgatitë, përpara çdo aderimi të ri në Konventë, një opinion për Komitetin e Ministrave, në lidhje me nivelin e mbrojtjes së të dhënave personale të kandidatit për anëtarësim dhe, kur është e nevojshme, të rekomandojë marrjen e masave për përputhshmërinë me dispozitat e kësaj Konvente;

f) me kërkesë të një Shteti ose organizate ndërkombëtare, mund të vlerësojë nëse niveli i mbrojtjes së të dhënave, që përcakton ky i fundit, është në përputhje me dispozitat e kësaj Konvente dhe kur është e nevojshme, të rekomandojë marrjen e masave për të siguruar këtë përputhshmëri;

g) mund të krijojë ose të miratojë modele të masave mbrojtëse të standardizuara referuar nenit 14;

h) do të rishikojë zbatimin e kësaj Konvente nga Palët dhe do të rekomandojë masa që duhet të merren, në rastin kur një Palë nuk është në përputhje me këtë Konventë;

i) do të lehtësojë, kur është e nevojshme, zgjidhjen miqësore të të gjitha vështirësive lidhur me zbatimin e kësaj Konvente.".

Neni 30

Teksti i nenit 20 të Konventës (neni 24 i ri) zëvendësohet me sa vijon:

"1. Komiteti i Konventës do të mblidhet nga Sekretari i Përgjithshëm i Këshillit të Evropës. Takimi i tij i parë do të mbahet brenda dymbëdhjetë muajve nga hyrja në fuqi e kësaj Konvente. Më pas do të takohet të paktën një herë në vit dhe, në çdo rast, kur një e treta e përfaqësuesve të Palëve kërkojnë mbledhjen e tij.

2. Pas secilës prej mbledhjeve të tij, Komiteti i Konventës i paraqet Komisionit të Ministrave të Këshillit të Evropës një raport mbi punën e tij dhe funksionimin e kësaj Konvente.

3. Marrëveshjet e votimit në Komitetin e Konventës përcaktohen në elementet për rregullat e procedurës të bashkangjitura në protokollin CETS nr. [223].

4. Komiteti i Konventës harton elementet e tjera të rregullave të tij të procedurës dhe përcakton, veçanërisht, procedurat e vlerësimit dhe të rishikimit të përmendura në nenin 4, paragrafi 3 dhe nenin 23, shkronjat "f" dhe "h" në bazë të kriterit të objektivave.".

Neni 31

1. Paragrafët 1 deri në 4 të nenit 21 të konventës (neni i ri 25) zëvendësohet, si vijon:

"1. Ndryshimet në këtë Konventë mund të propozohen nga një Palë, Komiteti i Ministrave i Këshillit të Evropës ose Komiteti i Konventës.

2. Çdo propozim për ndryshim u komunikohet Palëve të kësaj Konvente nga Sekretari i Përgjithshëm i Këshillit të Evropës, Shteteve të tjera anëtare të Këshillit të Evropës, Bashkimit Evropian dhe çdo Shteti joanëtar ose organizate ndërkombëtare, që janë ftuar të aderojnë në këtë Konventë, në përputhje me dispozitat e nenit 27.

3. Për më tepër, çdo ndryshim i propozuar nga një Palë ose Komiteti i Ministrave, do t'i komunikohet Komitetit të Konventës, i cili do t'i paraqesë Komitetit të Ministrave mendimin e tij mbi atë ndryshim të propozuar.

4. Komiteti i Ministrave do të marrë në konsideratë ndryshimin e propozuar dhe çdo opinion të paraqitur nga Komiteti i Konventës dhe mund të aprovojë ndryshimin.".

2. Një paragraf shtesë 7 do të shtohet pas paragrafit 6 të nenit 21 të Konventës (neni i ri 25) si më poshtë:

"7. Për më tepër, pasi të konsultohet me Komitetin e Konventës, Komiteti i Ministrave mund njëzëri të vendosë që një ndryshim i veçantë hyn në fuqi me skadimin e një periudhe trevjeçare nga data në të cilën ai është hapur për pranim, përveç nëse një Palë njofton Sekretarin e Përgjithshëm të Këshillit të Evropës për një kundërshtim për hyrjen e tij në fuqi. Nëse njoftohet një kundërshtim i tillë, ndryshimi do të hyjë në fuqi ditën e parë të muajit pas datës në të cilën Pala e kësaj Konvente, e cila ka njoftuar kundërshtimin ka depozituar instrumentin e saj të pranimit te Sekretari i Përgjithshëm i Këshillit të Evropës.".

Neni 32

1. Paragrafi 1 i nenit 22 të Konventës (neni i ri 26) zëvendësohet me sa vijon:

"1. Kjo Konventë do të jetë e hapur për nënshkrim nga Shtetet anëtare të Këshillit të Evropës dhe nga Bashkimi Evropian. Ajo u nënshtrohet ratifikimit, pranimit ose aprovimit. Instrumentet e ratifikimit, pranimit ose aprovimit do të depozitohen pranë Sekretarit të Përgjithshëm të Këshillit të Evropës.".

2. Shprehja "Shtet Anëtar" në paragrafin 3 të nenit 22 të Konventës (neni 26 i ri) zëvendësohen me "Palë".

Neni 33

1. Titulli dhe teksti i nenit 23 të Konventës (neni i ri 27) zëvendësohet, si vijon:

"Neni 27 – Aderimi nga shtetet joanëtare ose organizatat ndërkombëtare

1. Pas hyrjes në fuqi të kësaj Konvente, Komiteti i Ministrave i Këshillit të Evropës mund, pasi të konsultohet me Palët në këtë Konventë dhe të marrë marrëveshjen e tyre unanime, dhe në dritën e opinionit të përgatitur nga Komiteti i Konventës, në përputhje me nenin 23 p.sh., të ftojë çdo shtet që nuk është anëtar i Këshillit të Evropës ose një organizatë ndërkombëtare të aderojë në këtë Konventë, me një vendim të marrë nga shumica e parashikuar në nenin 20(d) të Statutit të Këshillit të Evropës dhe me votën unanime të përfaqësuesit të Shteteve Kontraktues që kanë të drejtën për t'u ulur në Komitetin e Ministrave.

2. Në lidhje me çdo shtet ose organizatë ndërkombëtare që i bashkohet kësaj Konvente, sipas paragrafit 1 më lart, Konventa do të hyjë në fuqi ditën e parë të muajit pas skadimit të një periudhe prej tre muajsh nga data e depozitimit të instrumentit të pranimit me Sekretarin e Përgjithshëm të Këshillit të Evropës.".

Neni 34

Paragrafët 1 dhe 2 të nenit 24 të Konventës (neni i ri 28) zëvendësohen me sa vijon:

"1. Çdo shtet, Bashkimi Evropian ose një organizatë tjetër ndërkombëtare mund, në kohën e nënshkrimit ose kur të depozitojnë instrumentin e tij të ratifikimit, pranimit, miratimit ose aderimit, të specifikojë territorin ose territoret në të cilat do të zbatohet kjo Konventë.

2. Çdo shtet, Bashkimi Evropian ose një organizatë tjetër ndërkombëtare mund, në çdo datë të mëvonshme, me një deklaratë drejtuar Sekretarit të Përgjithshëm të Këshillit të Evropës, të zgjasë zbatimin e kësaj Konvente në çdo territor tjetër të specifikuar në deklaratë. Për sa i përket këtij territorit, Konventa do të hyjë në fuqi ditën e parë të muajit pas skadimit të një periudhe prej tre muajsh nga data e marrjes së një deklarate të tillë nga Sekretari i Përgjithshëm.".

Neni 35

1. Shprehja "Shtet" në paragrafin e nenit 27 të Konventës (neni 31 i ri) zëvendësohet me "Palë".

2. Referencat për "nenet 22, 23 dhe 24" në shkronjën "c" zëvendësohen me referenca në "nenet 26, 27 dhe 28".

Neni 36

Nënshkrimi, ratifikimi dhe aderimi

1. Ky Protokoll do të jetë i hapur për nënshkrim nga Shtetet Kontraktuese në Konventë. Do t'u nënshtrohet ratifikimit, pranimit ose aprovimit. Instrumentet e ratifikimit, pranimit ose aprovimit depozitohen pranë Sekretarit të Përgjithshëm të Këshillit të Evropës.

2. Pas hapjes për nënshkrim të këtij Protokolli dhe para hyrjes në fuqi të tij, çdo shtet tjetër do të shprehë pëlqimin e tij për të nënshkruar këtë Protokoll duke aderuar. Ai mund të mos bëhet palë në Konventë pa aderuar njëkohësisht në këtë Protokoll.

Neni 37

Hyrja në fuqi

1. Ky Protokoll hyn në fuqi ditën e parë të muajit pas skadimit të një periudhe prej tre muajsh pas datës në të cilën të gjithë Palët e Konventës kanë shprehur pëlqimin e tyre për të nënshkruar këtë Protokoll, në përputhje me dispozitat e paragrafit 1 të nenit 36.

2. Në rast se ky Protokoll nuk ka hyrë në fuqi në përputhje me paragrafin 1, pas skadimit të një periudhe pesëvjeçare pas datës në të cilën është hapur për nënshkrim, Protokolli do të hyjë në fuqi për ato shtete që kanë shprehur pëlqimin e tyre për të nënshkruar me të, në përputhje me paragrafin 1, me kusht që Protokolli të ketë të paktën tridhjetë e tetë Palë. Ndërsa ndërmjet Palëve në Protokoll, të gjitha dispozitat e Konventës së ndryshuar do të kenë efekt menjëherë pas hyrjes në fuqi.

3. Në pritje të hyrjes në fuqi të këtij Protokolli dhe pa paragjykuar dispozitat, në lidhje me hyrjen në fuqi dhe aderimin nga shtetet joanëtare ose organizata ndërkombëtare, një Palë në Konventë mund, në kohën e nënshkrimit të këtij Protokolli ose në ndonjë moment tjetër, të deklarojë se do të zbatojë dispozitat e këtij Protokolli në baza provizore. Në raste të tilla, dispozitat e këtij Protokolli do të zbatohen vetëm në lidhje me Palët e tjera të Konventës që kanë bërë një deklaratë për të njëjtin efekt. Një deklaratë e tillë hyn në fuqi ditën e parë të muajit të tretë pas datës së marrjes së saj nga Sekretari i Përgjithshëm i Këshillit të Evropës.

4. Nga data e hyrjes në fuqi të këtij Protokolli, Protokolli shtesë i Konventës për Mbrojtjen e

Individëve, në lidhje me Përpunimin Automatik të të Dhënave Personale, në lidhje me autoritetet mbikëqyrëse dhe qarkullimin ndërkufitar të të dhënave (ETS Nr. 181), do të shfuqizohet.

5. Nga data e hyrjes në fuqi të këtij Protokolli, ndryshimet në Konventën për Mbrojtjen e Individëve, në lidhje me Përpunimin Automatik të të Dhënave Personale, të miratuar nga Komiteti i Ministrave, në Strasburg, më 15 qershor 1999, kanë humbur qëllimin e tyre.

Neni 38
Deklaratat lidhur me Konventën

Nga data e hyrjes në fuqi të këtij protokolli, për sa i përket një Pale që nënshkruajnë një ose më shumë deklarata, në përputhje me nenin 3 të Konventës, këto deklarata bien.

Neni 39
Rezervat

Nuk mund të bëhen rezerva për dispozitat e këtij protokolli.

Neni 40
Njoftimet

Sekretari i Përgjithshëm i Këshillit të Evropës do të njoftojë Shtetet Anëtare të Këshillit të Evropës dhe çdo Palë tjetër të Konventës, për:

a) çdo nënshkrim;

b) depozitimi i çdo instrumenti ratifikimi, pranimi, aprovimi ose aderimi;

c) data e hyrjes në fuqi të këtij protokolli në përputhje me nenin 37;

d) çdo akt tjetër, njoftim ose komunikim lidhur me këtë Protokoll.

Në dëshmi të kësaj, të nënshkruarit, duke qenë të autorizuar si duhet, kanë nënshkruar këtë Protokoll.

Bërë në Strasburg, më 10 tetor 2018, në anglisht dhe frëngjisht, të dyja tekstet janë po aq autentike, në një kopje të vetme, e cila do të depozitohet në arkivat e Këshillit të Evropës. Sekretari i Përgjithshëm i Këshillit të Evropës do t'iu transmetojë kopjet e vërtetuara secilit shtet anëtar të Këshillit të Evropës, Palëve të tjera të Konventës dhe çdo Shteti të ftuar të aderojë në Konventë.

Shtojca për protokollin: Elementet për rregullat e procedurës së Komitetit të Konventës

1. Çdo palë ka të drejtën e votës dhe do të ketë një votë.

2. Një shumicë prej dy të tretave të përfaqësuesve të Palëve do të përbëjnë një kuorum për mbledhjet e Komitetit të Konventës. Në rast se Protokolli ndryshues i Konventës hyn në fuqi në përputhje me nenin 37(2) përpara hyrjes në fuqi të tij, sa u përket të gjitha Shteteve Kontraktuese në Konventë, kuorumi për mbledhjet e Komitetit të Konventës do të jetë jo më pak se 34 Palë në Protokoll.

3. Vendimet sipas nenit 23 merren me shumicë prej katër të pestave. Vendimet në përputhje me nenin 23 shkronja "h" do të merren nga një shumicë prej katër të pestave, duke përfshirë një shumicë të votave të Shteteve Palë, që nuk janë anëtare të një organizate rajonale integrimi që është Palë në Konventë.

4. Kur Komiteti i Konventës merr vendime, në përputhje me nenin 23, shkronja "h", Pala e interesuar nga rishikimi nuk do të votojë. Kurdo që një vendim i tillë ka të bëjë me një çështje që është në kompetencën e një organizate rajonale integrimi, as organizata, as shtetet anëtare të saj nuk do të votojnë.

5. Vendimet lidhur me çështje procedurale do të merren nga një shumicë e thjeshtë.

6. Organizatat e integrimit rajonal, në çështjet brenda kompetencës së tyre, mund të ushtrojnë të drejtën e tyre të votës në Komitetin e Konventës, me një numër votash të barabartë me numrin e Shteteve të tyre anëtare që janë Palë në Konventë. Një organizatë e tillë nuk e ushtron të drejtën e saj të votës nëse ndonjë prej Shteteve Anëtare e ushtron të drejtën e tij.

7. Në rast të votimit, të gjitha Palët duhet të informohen për temën dhe kohën e votimit, si dhe nëse votimi do të ushtrohet nga Palët individualisht ose nga një organizatë rajonale integrimi në emër të Shteteve të saj Anëtare.

8. Komiteti i Konventës mund të ndryshojë më tej rregulloren e tij të procedurës me një shumicë prej dy të tretave, përveç marrëveshjeve të votimit, të cilat mund të ndryshohen vetëm me votim unanime të Palëve dhe për të cilat zbatohet neni 25 i Konventës.

DEKRET
Nr. 13622, datë 20.5.2022

PËR SHPALLJE LIGJI

Në mbështetje të nenit 84, pika 1, dhe nenit 93 të Kushtetutës,

DEKRETOJ:

Shpalljen e ligjit nr. 49/2022, "Për ratifikimin e protokollit ndryshues të Konventës 'Për mbrojtjen e individëve në lidhje me përpunimin automatik të të dhënave personale"'.

PRESIDENT I REPUBLIKËS
SË SHQIPËRISË
Ilir Meta

UDHËZIM
Nr. 10, datë 20.4.2022

PËR PËRCAKTIMIN E PROCEDURËS, LLOJIT DHE MËNYRËS PËR DHËNIEN E SHËRBIMEVE *ONLINE* TË SHËRBIMIT GJEOLOGJIK SHQIPTAR

Në mbështetje të pikës 4, të nenit 102, të Kushtetutës, të ligjit nr. 111/2015, "Për shërbimin gjeologjik shqiptar", të vendimit nr. 111, datë 2.3.2022, të Këshillit të Ministrave, "Për përcaktimin e fushës së përgjegjësisë shtetërore të Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë", si dhe në përputhje me urdhrin e Kryeministrit nr. 153 prot., datë 25.11.2019, "Për marrjen e masave dhe rregullimin e dispozitave ligjore për aplikimin e shërbimeve vetëm *on-line* nga data 1.1.2020",

UDHËZOJ:

1. Shërbimet që jepen *online*, nëpërmjet portalit unik të shërbimeve qeveritare *e-Albania*, nga Shërbimi Gjeologjik Shqiptar, janë:

a) oponenca për studime gjeologjike, hidrogjeologjike, gjeologo-inxhinierike, ambientale;

b) dhënie e dokumentacionit teknik gjeologo-minerar të arkivuar etj.;

c) studime në fushën e gjeoshkencës;

ç) harta të komponentëve të ndryshëm gjeologjikë.

2. Çdo kërkesë për marrjen e shërbimeve të parashikuara në pikën 1, bëhet vetëm nëpërmjet portalit unik të shërbimeve qeveritare *e-Albania* (në vijim portali *e-Albania*), nga qytetarët, bizneset apo institucionet.

3. Kostot për marrjen e shërbimeve të parashikuara në pikën 1, janë specifike sipas dokumentit gjeologjik të kërkuar, bazuar në tarifat e përcaktuara në udhëzimin e përbashkët me nr. 5105/5, datë 19.8.2021 dhe 11557/3, datë 31.8.2021, të ministrit të Infrastrukturës dhe Energjisë dhe të ministrit të Financave dhe Ekonomisë, "Për shërbimet me të tretët që kryhen nga Shërbimi Gjeologjik Shqiptar".

4. Çdo kërkesë për marrjen e shërbimit për "Oponenca për studime gjeologjike, hidrogjeologjike, gjeologo-inxhinierike, ambientale", duhet të shoqërohet me dokumentacionin si më poshtë, i cili ngarkohet nga kërkuesi në portalin *e-Albania*:

a) studimi dhe materiali grafik që kërkohet t'i bëhet oponenca sipas rastit;

b) harta dhe material tjetër grafik shoqërues i studimit.

5. Për marrjen e shërbimit nëpërmjet portalit *e-Albania* për "Oponenca për studime gjeologjike, hidrogjeologjike, gjeologo-inxhinierike, ambientale", ndiqet procedura si më poshtë:

a) kërkuesi identifikohet si qytetar ose biznes në portalin *e-Albania*;

b) pas zgjedhjes së shërbimit "Oponenca për studime gjeologjike, hidrogjeologjike, gjeologo-inxhinierike, ambientale", kërkuesi plotëson formularin elektronik me të dhënat e nevojshme të kërkuara;

c) pas plotësimit të kërkesës së përbashkët nga kërkuesi dhe dhënësi me të dhënat e nevojshme, bëhet konfirmimi i pagesës;

ç) kërkuesi brenda 15 ditëve, njoftohet te seksioni "Dokumentet e mia" në portalin *e-Albania* për shërbimin e kërkuar.

6. Për marrjen e shërbimit nëpërmjet portalit *e-Albania* për "Dhënie e dokumentacionit teknik gjeologo-minerar të arkivuar etj.", nuk nevojitet dokumentacion shoqërues.

7. Për marrjen e shërbimit nëpërmjet portalit *e-Albania* për "Dhënie e dokumentacionit teknik gjeologo-minerar të arkivuar etj.", ndiqet procedura si më poshtë:

a) kërkuesi identifikohet si qytetar ose biznes në portalin *e-Albania*;

b) pas zgjedhjes së shërbimit "Dhënie e dokumentacionit teknik gjeologo-minerar të arkivuar etj.", kërkuesi plotëson formularin elektronik me të dhënat e nevojshme të kërkuara;

c) pas plotësimit të formularit elektronik me të dhënat e nevojshme bëhet konfirmimi i pagesës;

ç) kërkuesi brenda 5–10 ditëve pune, nga konfirmimi i pagesës, njoftohet në seksionin "Dokumentet e mia", në portalin *e-Albania*, për studimet pa llogaritje rezervash;

d) kërkuesi brenda 20–30 ditëve pune, nga konfirmimi i pagesës, njoftohet në seksionin "Dokumentet e mia", në portalin *e-Albania*, për studimet me llogaritje rezervash.

8. Për marrjen e shërbimit nëpërmjet portalit *e-Albania* për "Studime në fushën e gjeoshkencës", nuk nevojitet dokumentacion shoqërues.

9. Për marrjen e shërbimit nëpërmjet portalit *e-Albania* për "Studime në fushën e gjeoshkencës", ndiqet procedura, si më poshtë:

a) kërkuesi identifikohet si qytetar ose biznes në portalin *e-Albania*;

b) pas zgjedhjes së shërbimit "Studime në fushën e gjeoshkencës", kërkuesi plotëson formularin elektronik me të dhënat e nevojshme të kërkuara;

c) pas plotësimit të formularit elektronik me të dhënat e nevojshme bëhet konfirmimi i pagesës.

ç) kërkuesi brenda 30–90 ditëve pune, nga konfirmimi i pagesës, njoftohet në seksionin "Dokumentet e mia", në portalin *e-Albania*, për shërbimin e kërkuar.

10. Për marrjen e shërbimit nëpërmjet portalit *e-Albania* për "Harta të komponentëve të ndryshëm gjeologjikë", nuk nevojitet dokumentacion shoqërues.

11. Për marrjen e shërbimit nëpërmjet portalit *e-Albania* për "Harta të komponentëve të ndryshëm gjeologjikë", ndiqet procedura si më poshtë:

a) kërkuesi identifikohet si qytetar ose biznes në portalin *e-Albania*;

b) pas zgjedhjes së shërbimit "Harta të komponentëve të ndryshëm gjeologjikë", kërkuesi plotëson formularin elektronik me të dhënat e nevojshme të kërkuara;

c) pas plotësimit të formularit elektronik me të dhënat e nevojshme bëhet konfirmimi i pagesës.

ç) kërkuesi brenda 5–10 ditëve pune, nga konfirmimi i pagesës, njoftohet në seksionin "Dokumentet e mia", në portalin *e-Albania*, për shërbimin e kërkuar.

12. Ngarkohet Shërbimi Gjeologjik Shqiptar për zbatimin e këtij udhëzimi.

Ky udhëzim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

MINISTËR I INFRASTRUKTURËS
DHE ENERGJISË
Belinda Balluku

UDHËZIM
Nr. 60, datë 9.5.2022

PËR PËRBËRJEN DHE FUNKSIONIMIN E KOMISIONEVE TË VLERËSIMIT TË GRADAVE

Në mbështetje të pikës 4 të nenit 102 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, pikës 3, të nenit 24, të ligjit nr. 152/2015, "Për shërbimin e mbrojtjes nga zjarri dhe shpëtimin",

UDHËZOJ:

1. Ngritjen e Komisioneve të Vlerësimit të Gradave për strukturat e shërbimit të mbrojtjes nga zjarri dhe shpëtimin në nivel qendror për punonjësit e nivelit të lartë, të mesëm, si dhe në nivel vendor për punonjësit e nivelit bazë.

2. Komisioni i Vlerësimit të Gradave për punonjësit e nivelin e lartë të strukturës së MZSH-së përbëhet nga:

a) Drejtor i Përgjithshëm i Shërbimit të MZSH-së,	kryetar;
b) Drejtor në Drejtorinë e Përgjithshme të MZSH-së,	anëtar;
c) Drejtor i Drejtorisë së Miradministrimit të Burimeve Njerëzore dhe Shërbimeve,	anëtar.

3. Komisioni i Vlerësimit të Gradave për punonjësit e nivelit të mesëm të strukturave të shërbimit të MZSH-së përbëhet nga:

a) Drejtor në Drejtorinë e Përgjithshme të MZSH-së;	kryetar;
b) Përgjegjës Sektori në Drejtorinë e Miradministrimit dhe Miradministrimit të	

Burimeve Njerëzore dhe Shërbimeve, anëtar;
c) Specialist në Drejtorinë e Përgjithshme të Shërbimit të MZSH-së, anëtar.

4. Komisioni i Vlerësimit të Gradave për punonjësit e nivelit bazë të strukturave të shërbimit të MZSH-së në nivel vendor, përbëhet nga:

a) Drejtor/Shef sektori i Shërbimit të MZSH-së në Njësinë e Vetëqeverisjes Vendore, kryetar;
b) Specialist i burimeve njerëzorë në Njësinë e Vetëqeverisjes Vendore, anëtar;
c) Specialist në Drejtorinë e Përgjithshme të Shërbimit të MZSH-së, anëtar

5. Komisionet e Vlerësimit të Gradave funksionojnë si organ kolegjial vlerësues dhe propozues në zbatim të dispozitave të ligjit nr. 152/2015, "Për shërbimin e mbrojtjes nga zjarri dhe shpëtimin" për fitimin e gradës. Komisionet dërgojnë aktet e vlerësimit për punonjësit e MZSH-së tek autoritetet e përcaktuara në nenin 24 të ligjit vetëm nëse janë plotësuar kriteret:

a) të këtë përmbushur kriteret për pozicionin e punës;

b) të jetë parashkruar masa disiplinore për shkelje të rëndë, sipas afatit të përcaktuar në ligjin nr. 152/2015;

c) vlerësimi i aftësive individuale të punës të jetë jo më i ulët se 70% të vlerësimit të përgjithshëm;

ç) të ketë përfunduar trajnimin e detyrueshëm për gradë pranë Akademisë së Sigurisë.

d) të mos ketë filluar ndaj tij procedim penal;

dh) të mos ketë filluar ndaj tij procedim disiplinor për shkelje të rëndë;

e) të ketë plotësuar kohën e qëndrimit në gradë, sipas afateve të përcaktuara në nenin 25 të ligjit nr. 152/2015.

6. Komisionet e Vlerësimit të Gradave trajtojnë çdo kërkesë të punonjësve të shërbimit të MZSH-së, për vlerësimin e gradave, brenda 30 ditëve nga depozitimi i kërkesës.

7. Komisionet e Vlerësimit të Gradave, në përfundim të shqyrtimit të kërkesës, hartojnë aktin e vlerësimit, në përputhje me kriteret e ecurisë dhe fitimit të gradave, sipas përcaktimeve të ligjit nr. 152/2015, "Për shërbimin e mbrojtjes nga zjarri dhe shpëtimin", dhe vendimit nr. 895, datë 21.12.2016, të Këshillit të Ministrave, "Për kriteret e ecurisë dhe fitimit të gradave, njësimin e funksioneve korresponduese për çdo gradë, paraqitjen, formën dhe specifikimet teknike të gradave të shërbimit të mbrojtjes nga zjarri dhe shpëtimin".

8. Anëtarët e Komisionit të Vlerësimit të Gradave nuk mund të vlerësojnë dhe të trajtojnë një kërkesë nëse ekziston një nga shkaqet e parashikuara në ligjin nr. 9367, datë 7.4.2005 "Mbi parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve publike", i ndryshuar, dhe neneve 30 dhe 31, të ligjit nr. 44/2015 "Kodi i Procedurave Administrative në RSH".

9. Anëtari Komisionit të Vlerësimit të Gradave, i cili është në dijeni të një konflikti interesi ose të një pengese ligjore për një anëtar të komisionit njofton duke parashtruar arsyet për të cilat kërkohet zëvendësimi sipas funksionit, dhe në çdo rast nuk mund të jetë pjesë e këtij komisioni në rastet e kur ai vetë kërkon ose vlerësohet me gradë, sipas kritereve të nenet 25 dhe 26, të ligjit nr. 152/2015 "Për shërbimin e mbrojtjes nga zjarri dhe shpëtimin" dhe vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 895, datë 21.12.2016, "Për kriteret e ecurisë dhe fitimit të gradave, njësimin e funksioneve korresponduese për çdo gradë, paraqitjen, formën dhe specifikimit teknike të gradave të shërbimit të mbrojtjes nga zjarri dhe shpëtimin".

10. Ankimi i punonjësve të shërbimit të MZSH-së, mbi propozimin e Komisionit të Vlerësimit të Gradave, trajtohet rast pas rasti, në përputhje me parashikimet e kreut II, të ligjit nr. 44/2015 "Kodi i Procedurave Administrative në Republikën e Shqipërisë".

11. Ngarkohet për zbatimin e këtij udhëzimi, Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimit të MZSH-së, Drejtoria e Miradministrimit të Burimeve Njerëzore dhe Shërbimeve, si dhe Njësitë e Qeverisjes Vendore që kanë strukturat përkatëse të këtij shërbimi.

12. Ngarkohet Sekretari i Përgjithshëm të sigurojë zbatimin dhe kontrollin e zbatimit të këtij udhëzimi.

13. Udhëzimi nr. 211, datë 3.4.2017, "Për përbërjen dhe funksionimin e vlerësimit të gradave", shfuqizohet.

Ky udhëzim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

MINISTËR I BRENDSHËM
Bledar Çuçi

UDHËZIM
Nr. 64, datë 12.5.2022

PËR PËRCAKTIMIN E KRITEREVE TË VEÇANTA TË DHËNIES SË CERTIFIKATËS, PËR USHTRIMIN E AKTIVITETIT TË EKSPERTIT PRIVAT NË FUSHËN E MBROJTJES NGA ZJARRI DHE SHPËTIMIN

Në mbështetje të pikës 4, të nenit 102 të Kushtetutës, pikën 4, të nenit 49, të ligjit nr. 152/2015, "Për shërbimin e mbrojtjes nga zjarri dhe shpëtimin",

UDHËZOJ:

I. KRITERET E VEÇANTA PËR PAJISJEN ME CERTIFIKATË

1. Drejtoria e Përgjithshme e shërbimit të MZSH-së, jep certifikatë, sipas formatit bashkëlidhur dhe pjesë përbërëse e këtij udhëzimi, për personat fizikë dhe juridikë, vendas apo të huaj, për certifikimin profesional të ekspertit zjarrfikës privat, të klasifikuara si më poshtë:

a) "Kryerja e aktekspertimeve për zjarret e rëna";

b) "Hartimi i projekteve të mbrojtjes nga zjarri dhe shpëtimin";

c) "Kryerja e trajnimeve në fushën e mbrojtjes nga zjarri dhe për shpëtimin".

2. Për pajisjen me certifikatë të tipit "Kryerja e aktekspertimeve për zjarret e rëna", subjekti fizik duhet të plotësojë kriteret e mëposhtme:

a) të ketë përfunduar arsimimin e lartë në Akademinë e Sigurisë, në Arsimin e Lartë Ushtarak ose të jetë i diplomuar në degët Inxhinierisë, minimumi niveli "Bachelor";

b) të ketë të paktën 5 vjet eksperiencë pune si punonjës të nivelit mesëm dhe të nivelit të lartë të shërbimit zjarrfikës;

c) të ketë përfunduar kualifikimin përkatës në fushën e mbrojtjes nga zjarri dhe shpëtimin të certifikuar në Akademinë e Sigurisë, ose në një nga qendrat e trajnimit zjarrfikës brenda dhe jashtë vendit.

2.1 Subjektet fizike të huaja duhet të plotësojmë kriteret e përcaktuara në germat "a", "b" dhe "c", si dhe të kenë njësuar pranë ministrisë përgjegjëse për arsimimin, diplomën ekuivalente të lëshuar nga institucionet përkatëse të huaja.

3. Për pajisjen me certifikatë të tipit "Hartimi i dokumentacionit të projekteve teknike për mbrojtjen nga zjarri dhe shpëtimin", subjekti fizik vendas apo i huaj duhet të plotësojë kriteret e mëposhtme:

a) të disponojë diplomë të nivelit "Master profesional apo shkencor", në degët "Inxhinieri Ndërtimi", "Inxhinieri Hidroteknike", "Inxhinieri Fizike", "Inxhinieri e Proceseve Kimike", "Inxhinieri Elektrike", "Inxhinieri Mekanike", "Arkitekturë dhe Urbanistikë" dhe "Inxhinieri Gjeologji dhe Miniera";

b) të ketë vjetërsi pune mbi 5 vjet në fushën e projektimit të objekteve;

c) plotësimin e dokumentacionit sipas kreut III të këtij udhëzimi.

3.1 Subjektet fizike të huaja duhet të plotësojmë kriteret e përcaktuar në germat "a" dhe "b" dhe "c", të pikës 3, të këtij kreu, si dhe të kenë njësuar pranë ministrisë përgjegjëse për arsimimin, diplomën ekuivalente të lëshuar nga institucionet përkatëse të huaja.

3.2 Subjekti juridik vendas apo i huaj mund të aplikoj për pajisjen me certifikatë të tipit "Hartimi i dokumentacionit të projekteve teknike për mbrojtjen nga zjarri dhe shpëtimin" në emër të drejtuesit teknik të shoqërisë, i cili plotëson kriteret e përcaktuara në germat "a", "b" dhe "c", të pikës 3, të këtij kreu. Në këtë rast subjekti duhet të paraqesë në dokumentet e mëposhtme në platformën elektronike *e-Albania*;

a) kontratë pune, në të cilën duhet të rezultojë që drejtuesi teknik i shoqërisë duhet të jetë në marrëdhënie pune me subjektin juridik, për një periudhë kohe jo më pak se një vit;

b) plotësimin e dokumentacionit sipas kreun III, të këtij udhëzimi.

4. Për pajisjen me certifikatë të tipit "Kryerja e trajnimeve në fushën e mbrojtjes nga zjarri dhe për shpëtimin" subjekti fizik vendës apo i huaj duhet të plotësojë kriteret e mëposhtme:

a) të ketë përfunduar arsimimin në nivelin "Bachelor" në Akademinë e Sigurisë, Arsimin e Lartë Ushtarak, ose të jetë i diplomuar në një nga degët e "Inxhinierisë";

b) të ketë eksperiencë jo më pak se 5 vjet në shërbimin zjarrfikës si punonjës të nivelit e mesëm dhe të nivelit të lartë të shërbimit zjarrfikës ose të

jetë certifikuar në Akademinë e Sigurisë dhe në qendrat e trajnimit zjarrfikës brenda ose jashtë vendit;

c) Plotësimin e dokumentacionit sipas kreut III të këtij udhëzimi.

4.1 Subjekti fizik i huaj duhet të plotësoj kriteret e përcaktuara në germat "a", "b" dhe "c", të pikës 4, të këtij kreu, si dhe të ketë njësuar pranë ministrisë përgjegjëse për arsimin, si dhe diplomën ekuivalente të lëshuar nga institucionet përkatëse të huaja.

4.2 Subjekti juridik vendas apo i huaj, mund të aplikojë për certifikatë të tipit "Kryerja e trajnimeve në fushën e mbrojtjes nga zjarri dhe për shpëtimin" në emër të drejtuesit teknik të shoqërisë, i cili plotëson kriteret e përcaktuara në germat "a", "b" dhe "c", të pikës 4, të këtij kreu.

II. OBJEKTI I PUNËS SË EKSPERTIT ZJARRFIKËS PRIVAT

1. Eksperti zjarrfikës privat i certifikuar "Për kryerjen e aktekspertizave për zjarret e rëna", kryen:

a) ndihmon në këqyrjen e vendit të ngjarjes, ku ka rënë zjarri;

b) studimi i dosjes hetimore lidhur me ngjarjen.

c) hartimin e aktekspertizës kur caktohet nga institucionet e prokurorisë, gjykatës, në përputhje me dispozitat e Kodit të Procedurës Penale dhe Kodit të Procedurës Civile, si dhe kur kërkohet nga personat fizik.

2. Eksperti zjarrfikës privat i certifikuar "Për hartimin e projekteve të mbrojtjes nga zjarri dhe për shpëtimin", kryen:

a) hartimin e dokumentacionit të projektit teknik të mbrojtjes nga zjarri dhe për shpëtimin për të gjitha llojet e objekteve dhe veprave të ndryshme në përputhje me legjislacionin përkatës;

b) përgatitjen e relacionit teknik të projektit të mbrojtjes nga zjarri dhe për shpëtimin.

3. Eksperti zjarrfikës privat i certifikuar "Për kryerjen e trajnimeve në fushën e mbrojtjes nga zjarri dhe për shpëtimin", kryen:

a) trajnime që lidhen me dhënien e njohurive në fushën e mbrojtjes nga zjarri dhe shpëtimit për subjekte të ndryshme juridikë apo fizikë, publikë, me përjashtim të personelit të shërbimit të MZSH-së apo privatë;

b) organizimin dhe zhvillimin e trajnimeve, takimeve, apo ushtrimeve demonstrative me institucione dhe subjekte të ndryshme për dhënien e njohurive mbi masat e mbrojtjes nga zjarri;

c) hartimin e programeve të stërvitjes në fushën e mbrojtjes nga zjarri dhe për shpëtimin.

III. KËRKESA PËR PAJISJEN ME CERTIFIKATË PËR USHTRIMIN E AKTIVITETIT TË EKSPERTIT ZJARRFIKËS PRIVAT DHE SHQYRTIMI I DOKUMENTACIONIT

1. Subjekti i interesuar për pajisjen me certifikatë për ushtrimin e aktivitetit të ekspertit zjarrfikës privat, duhet të aplikojë *online* nëpërmjet portalit *e-Albania* dhe ngarkon dokumentacionin;

a) kërkesë për tu pajisur me certifikatën e ekspertit zjarrfikës privat sipas kategorizimit;

b) fotokopje e diplomës e noterizuar;

c) jetëshkrim;

d) 1 fotografi me përmasa 4 x 6 cm;

e) akti i regjistrimit në QKB (ekstrakt QKB);

f) dokumentacion teknik justifikues për çka është përshkruar si veprimtari e kryer në CV: vërtetime nga subjekte, institucione, certifikata kursi trajnimi apo specializimi, që kanë lidhje me fushën ku kërkohet të licencohet. Të gjitha dokumentet justifikuese të kenë të përfshirë NIPT-in, nënshkrimin me vulën e subjektit fizik/juridik, adresën postare ose elektronike të subjektit që ka lëshuar dokumentin.

1.1 Kërkesa për pajisjen me certifikatë dhe dokumentacioni shoqërues i noterizuar duhet të jetë në gjuhën shqipe.

2. Kërkesa për pajisjen me certifikatë shqyrtohet nga një komision i posaçëm, i ngritur pranë Drejtorisë së Përgjithshme të MZSH-së, i cili përbëhet nga:

a) drejtor i Inspektimit dhe Koordinimit në Drejtorinë e PMZSH-së, në cilësinë e kryetarit;

b) 1 specialist i Drejtorisë së Përgjithshme të MZSH-së, në cilësinë e anëtarit;

c) 1 specialist në Drejtorinë e Programimit, Standardizimit të Kuadrit Rregullator, në cilësinë e anëtarit.

3. Komisioni për shqyrtimin e kërkesës, trajton dhe vlerëson dokumentacionin e dorëzuar brenda 25 ditëve kalendarike nga paraqitja e kërkesës dhe vendos, për:

a) plotësimin e dokumentacionit;

b) refuzimin e kërkesës;

c) dhënien e certifikatës.

4. Certifikata për ushtrimin e aktivitetit të ekspertit zjarrfikës privat është pa afat dhe i prodhon efektet nga data e marrjes së saj.

5. Komisioni mbështetet nga Sekretariati Teknik, nga një specialist në Drejtorinë e PMZSH-së i cili kryen funksionin e Sekretariatit Teknik.

6. Në mbledhje, komisioni shqyrton aplikimet, dokumentacionin e paraqitur nga Sekretariati Teknik.

7. Mbledhjet e Komisionit mbahen në përputhje me ligjin nr. 8480, datë 27.5.199, "Për funksionimin e organeve kolegjiale".

8. Komisioni i përcaktuar në pikën 2, të kreut III, për shqyrtimin e kërkesës trajton dhe vlerëson dokumentacionin e dorëzuar brenda 25 ditëve nga momenti i konfirmimit nga punonjësi i sekretariatit teknik, si dhe vendos, për:

a) refuzimin e kërkesës duke evidentuar shkakun e refuzimit;

b) dhënien e certifikatës.

9. Sekretariati Teknik në rastet kur identifikon mungesë në dokumentacionin e kërkuar për aplikim, vë në dijeni komisionin dhe njofton aplikantin për plotësimin e tij.

10. Vendimet në komision si rregull merren me konsensus. Kur konsensusi nuk arrihet vota e kryetarit është përcaktuese.

11. Vendimet në Komision përgatiten nga Sekretariati Teknik dhe nënshkruhen nga kryetari dhe anëtarët e Komisionit që kanë qenë pjesëmarrës në mbledhje.

12. Mbi bazën e vendimit të komisionit lëshohet certifikata e ekspertit zjarrfikës sipas formatit bashkëlidhur këtij udhëzimi.

13. Komisioni i ngritur pranë Drejtorisë së Përgjithshme të MZSH-së mund të revokojë certifikatën e ushtrimit të aktivitetit të ekspertit zjarrfikës privat në fushën e mbrojtjes nga zjarri dhe shpëtimin, në rast se:

a) është lëshuar në kundërshtim me kriteret e përcaktuara në këtë udhëzim.

b) vërtetohet se personi fizik apo juridik ka përdorur dokumente të falsifikuara për t'u pajisur me certifikatë;

c) konstatohet shkelja e rregullave për përpilimin e aktekspertimeve, të hartimit të dokumentacionit teknik të projekteve të mbrojtjes nga zjarri dhe të shpëtimit, nga strukturat e shërbimit të MZSH-së në nivel vendor dhe qendror.

14. Ndaj vendimit të Komisionit, subjektet aplikues kanë të drejtën e ankimit pranë ministrit përgjegjës, brenda 30 ditëve kalendarike nga data e njoftimit.

15. Autoriteti përgjegjës për shqyrtimin e ankesës brenda 15 ditëve kalendarike vendos:

a) lënien në fuqi të vendimit të marrë nga komisioni;

b) rikthim për rishqyrtim të vendimmarrjes së komisionit.

16. Lidhur me mos pranimin e ankesës sipas piks 14 të këtij udhëzimi, subjekti ka të drejtën e ankimimit në gjykatën administrative.

IV. ADMINISTRIMI DHE RUAJTJA E DOKUMENTACIONIT

1. Drejtoria e Përgjithshme e MZSH-së administron regjistrin e gjithë ekspertëve në fushën e mbrojtjes nga zjarri dhe shpëtimit, sipas kategorizimit të pikës 1 të këtij udhëzimi.

2. Regjistri i ekspertëve në fushën e mbrojtjes nga zjarri dhe për shpëtimin përmban identitetin, arsimimin e subjektit, data e lëshimit të certifikatës, adresën elektronike edhe kontaktin e telefonit.

V. DISPOZITA TË FUNDIT

1. Udhëzimi nr. 11, datë 10.12.2002, i ish-ministrit të Pushtetit Vendor dhe Decentralizimit "Për kriteret profesionale të dhënies së lejes për ushtrimin e ekspertit privat zjarrfikës", shfuqizohet.

Ky udhëzim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

MINISTËR I BRENDSHËM
Bledar Çuçi

BIBLIOGRAFIA E INFORMACIONIT TË DEKLASIFIKUAR "SEKRET SHTETËROR" NË DREJTORINË E PËRGJITHSHME TË ARKIVAVE

Bazuar në ligjin nr. 8457, datë 11.2.1999, "Për informacionin e klasifikuar 'Sekret shtetëror'", të ndryshuar, si dhe vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 662, datë 15.11.2017, "Për miratimin e rregullores për deklasifikimin dhe zhvlerësimin e informacionit të klasifikuar 'Sekret Shtetëror', Komisioni i Deklasifikimit dhe Zhvlerësimit të informacionit të klasifikuar "Sekret shtetëror" në Drejtorinë e Përgjithshme të Arkivave, i mbledhur më datë 13.5.2022, vendosi të deklasifikojë informacionet e klasifikuara "Sekret shtetëror", si më poshtë:

1. **Deklasifikohen plotësisht informacionet (dosjet) e klasifikuara "Sekret shtetëror", si më poshtë:**

Fondi 14/APSTR, viti 1989

Dosjet 424, 425, 426, 427, 428, 429, 430, 431, 432, 433, 434, 435, 438, 439, 442, 444, 445, 446, 447, 448, 449, 450, 451, 453, 455, 456, 457, 458, 459, 460, 461, 462, 463, 464, 465, 466, 467, 468, 469, 470, 471, 472, 473, 474, 475, 476, 477, 478, 479, 480, 484, 485, 488, 489, 491, 492, 494, 495, 496, 497, 498, 499, 500, 501, 504, 505, 506, 507, 508, 509, 510, 511, 515, 517, 518, 520, 521, 522, 524, 525, 526, 527, 528, 529, 530, 531, 532, 533, 534, 535, 536, 537, 538, 539, 540, 541, 542, 543, 544, 550, 553, 559, 560, 561, 562, 563, 564, 565, 567, 569, 570, 572, 574, 575, 576, 579, 580, 581, 582, 583, 585, 586, 588, 591, 594, 599, 608, 611, 613, 614, 615, 616, 617, 618, 619, 620, 622, 623, 626, 627, 630, 631, 633, 634, 636, 637, 638, 641, 643, 644, 649, 655, 659, 660, 661, 663, 665, 666, 674, 679. 682, 683, 734, 737, 744, 789, 790, 791, 796, 797, 798, 799, 800, 801, 802, 803, 804, 805, 806, 808, 809, 812, 814, 816. Niveli i klasifikimit "Sekret". Dosja 828. Niveli i klasifikimit "T. sekret". Dosjet 835, 858, 862, 867, 873, 877, 908, 913, 927, 937, 938, 945, 946, 976, 996, 1001, 1002, 1004, 1005, 1008, 1015, 1021, 1023, 1026, 1032, 1033, 1034, 1035, 1036, 1037, 1038, 1039, 1040, 1041, 1042, 1045, 1046, 1047, 1048, 1049, 1051, 1053, 1054, 1058, 1059, 1060, 1061, 1063, 1064, 1066, 1069, 1071, 1072, 1073, 1079, 1080, 1081, 1083, 1084, 1085, 1086, 1087, 1088, 1090, 1093, 1094, 1097, 1106, 1109, 1110, 1111, 1114, 1120, 1124, 1128, 1129, 1130, 1135, 1140, 1141, 1142, 1143, 1145, 1146, 1149, 1150, 1155, 1161, 1166, 1170, 1176, 1177, 1180, 1181, 1187, 1190, 1195, 1197, 1199, 1201, 1205, 1208, 1216, 1219, 1221, 1226, 1227, 1228, 1229, 1230, 1233, 1235, 1236, 1238, 1241, 1244, 1247, 1256, 1258, 1259, 1261, 1262, 1268, 1269, 1271, 1272, 1275, 1277, 1282, 1290, 1292, 1293, 1297, 1301, 1308, 1309, 1320, 1335, 1337, 1343, 1345, 1351, 1352, 1353, 1354, 1355, 1356, 1357, 1358, 1359, 1360, 1361, 1362, 1363, 1364, 1366, 1368, 1369, 1370, 1371, 1379, 1380, 1381, 1384, 1385, 1386, 1405, 1406, 1412, 1413, 1433, 1444, 1448, 1453, 1461, 1463, 1466, 1472, 1478, 1481, 1484, 1486, 1487, 1488, 1490, 1494, 1495, 1496, 1497, 1498, 1499, 1500, 1501, 1502, 1503, 1507, 1513, 1530, 1535, 1565, 1570, 1571, 1593, 1598, 1606, 1613, 1614, 1636, 1662, 1664, 1674, 1675, 1678, 1679, 1680, 1681, 1682, 1684, 1685, 1686, 1687, 1688, 1689, 1690, 1691, 1692, 1693, 1694, 1697, 1704, 1708, 1712, 1715, 1723, 1730, 1731, 1737, 1740, 1745, 1746, 1747, 1748, 1751, 1779, 1785. Niveli i klasifikimit "Sekret".

2. Një kopje e bibliografisë t'i dërgohet DSIK-së, si dhe për botim në Fletoren Zyrtare.

KRYETAR
Ardit Bido

NJOFTIM
Nr. 6870, datë 20.5.2022

MBI HYRJEN NË FUQI TË NJË MARRËVESHJEJE NDËRKOMBËTARE

Marrëveshja e pjesshme e zgjeruar për rrugët kulturore, miratuar me rezolutën CM/RES (2013) 66, të Këshillit të Evropës, ka hyrë në fuqi, për Republikën e Shqipërisë, më 12 maj 2022.

SEKRETAR I PËRGJITHSHËM I MINISTRISË PËR EVROPËN DHE PUNËT E JASHTME
Armand Skapi

VENDIM
(i shkurtuar)

Gjykata e Rrethit Gjyqësor Shkodër, me vendimin nr. 53, datë 6.4.2022, vendosi njohjen dhe dhënien fuqi në Republikën e Shqipërisë, vendimit të huaj për çështjen civile me nr. 3744/18, datë 21.2.2019, të Gjykatës së *Lecce*-s, Republika e Italisë, me kërkuese Margarita Franja.

KËRKESË

Shtetasja Rukie Salia kërkon pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë shpalljen si të vdekur të shtetasit Xhavit Salia, i datëlindjes 4.4.1951, lindur në Tërbaç, Dibër dhe banues në Tiranë, dhe caktimin si datë vdekjeje datën 15.5.1997, si dhe përcaktimin e trashëgimtarëve ligjorë.

Rukie Salia

FLETORJA ZYRTARE E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË
Vulosur elektronikisht nga Qendra e Botimeve Zyrtare
Viti: 2022 - Numri: 79
Datë: 2022/05/26 15:30:39
a80908d6-5cce-42e8-ba58-9709acdfb7ba

Shënim: Ky dokument është gjeneruar dhe vulosur me anë të një procedure automatike nga një sistem elektronik (Qendra e Botimeve Zyrtare)

	Formati 61x86/8

Shtypshkronja e Qendrës së Botimeve Zyrtare
Tiranë, 2022

Adresa: Rr. "Nikolla Jorga", Tiranë
Tel./fax: +355 4 24 27 004 Tel.: +355 4 24 27 006

Çmimi 96 lekë